

Dua të bëj një sqarim për deklaratën e mëparshme. Në trashëgiminë kulturore, siç e tha edhe ministrja, futen objekte, godina, hapësira monument kulture, si dhe artefakte, kështu që edhe teatri bën pjesë në 2021 hapësirën monument kulture.

Prandaj, Ina, mos u shqetëso, se përgjigjen ia dhashë unë. Memorandumi është shumë i rëndësishëm, ai krijon mekanizma efektivë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe për këtë duhet duartrokatur dhe përsëritur. Të njëjtat filtra duhet të ndërmerren nga qeveria shqiptare, e pohoi edhe ministrja: “Nuk ka një kuadër të plotë ligjor për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore”. Tani është momenti për të vënë alarmin e kuq në lidhje me trashëgiminë kulturore, sepse e kemi krenarinë e themi: “Po, trashëgimia jonë kulturore është e pasur”. Po, është e pasur, por njëkohësisht është edhe e varfër, sepse është varfëruar në tri drejtime kryesore që u përmendën edhe nga kolegja ime. Në radhë të parë, nuk investohet trashëgimia kulturore, nuk ka një kërkesë dhe një përkushtim nga ana e qeverisë për kërkime të reja të objekteve të trashëgimisë kulturore, jo vetëm që nuk ka mbështetje, por nuk ka as financime për sektorin e arkeologjisë dhe për sektorin e trashëgimisë kulturore. Ne lavdërohem vetëm me ato objekte që janë zbuluar nga të huajt në pjesën më të madhe, jo nga ne. Nga ana tjetër, vazhdohet të ketë mungesë në burimet njerëzore dhe kjo lidhet me arsimin, sepse degët që prodhojnë burimet njerëzore për trashëgiminë kulturore në universitete, që i përkasin arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore, ose janë mbyllur, ose janë në mbyllje e sipër. Ne sot flasim për vlera të mëdha të trashëgimisë kulturore, pra nuk ka investime. Kjo trashëgimi është e pasur, por është varfëruar nga keqmenaxhimi, nga rrënimi që i ka ndodhur, nga selektimi i jetësimit. Është e vërtetë që çdo qeveri nuk ka para, sepse ky është justifikimi, por jo si qeveria shqiptare, që hedh vetëm 0,3% të buxhetit të saj për trashëgiminë kulturore, në fakt për ministrinë, sepse trashëgimia zë një pjesë akoma më të vogël. Pra, jo vetëm që është lënë që të rrënohet, por edhe në rastet kur është ndërhyrë, është ndërhyrë në mënyrë jo profesionale.

U përmend “Veliera”, unë do të përmend Kalanë e Rozafës, për të cilën pak njerëz e dinë. Muret e saj të rrëzuara janë lidhur me beton, që është skandaloze, është për të vënë duart në kokë. Jo vetëm kaq, por edhe në rastet kur janë bërë investimet për jetësim, janë bërë selektive. Në fakt, ajo që glorifikohet dhe investohet më shumë është periudha e komunizmit dhe kjo nuk është as çudi dhe as rastësi, pra është e qëllimshme. Nëse doni i marrim objektet me radhë dhe të shohim se cilat janë jetësuar: është shtëpia e Enver Hoxhës, Piramida, Shtëpia me Gjethe, a thua e gjithë historia e Shqipërisë, kaq krenare dhe kaq shekullore, të jetë e përqendruar dhe e projektuar vetëm tek objektet e komunizmit. Të mos harrojmë që ndër vite është shkatërruar dhe është rrafshuar Teatri Kombëtar, është rrafshuar Stadiumi Kombëtar, u rrafshua ATSH-ja dhe të njëjtin fat e pret edhe godinën e radios. Pra, do të vijë dita që edhe kjo godinë të rrafshohet, sikurse shumë objekte të tjera të dëmtuara, sidomos në bulevardin “Zogu i parë”, që janë pjesë e trashëgimisë historike dhe kulturore, sepse harrojmë termin “historike”, është “historike dhe kulturore”. Së treti, kjo pasuri është varfëruar, sepse është lënë që të vidhet e të trafikohet. Shqipëria është autostradë e kalimit të artefakteve të objekteve të ndryshme, që kanë vlerë arkeologjike dhe historike për Shqipërinë. Çfarë bën shteti shqiptar? Unë do të them vetëm një fakt: sa çështje penale janë hapur sot në lidhje me grabitjen dhe trafikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore? Zero vepra penale të regjistruara apo të dënua. Kjo do të thotë se këtu kalon gomari me gjithë kosha, sepse nuk ka mbikëqyrje. Le të specializohen doganierët, pas

marrëveshjes së sotme, por ky fakt ka ndodhur në vazhdimësi. E vetmja vepër penale është ajo e vitit 2012 kundër koleksionistit Gjergji Thimio, i cili u dënua dhe kërkon pafajësinë. Ai u dënua, sepse ishte i implikuar Kryeministri i Ramës në aferën e ikonave, të cilit Gjergji Thimio i ka nxjerrë edhe numrin e burgut në Francë për këtë çështje dhe askush nuk reagon. Për më tepër duhet të përmendim kallëzimin penal që shoqata “Për mbrojtjen e teatrit” ka bërë në SPAK ndaj bashkisë dhe ndaj qeverisë, por nuk ka asnjë lëvizje. Pra, nuk ka as vullnet politik dhe as gjyqësor.

Të më falin kolegët, por do ta lë këtu debatin për trashëgiminë, do të bëj një kapërcim, i cili lidhet me një term jo komun për ne, por që është jetësor për një pjesë banorëve të Librazhdit, do të flas për mullirin e Orenjës, i cili mbulon 10 fshatra. Ky është mulli bluarje; nuk po them që bën pjesë në trashëgiminë kulturore, por, po të kishte specialistë, edhe mund të bëhej pjesë, por nuk po i futem këtij debati, unë jam i bindur që bën pjesë në trashëgiminë jetësore të kësaj krahine. Historia e këtij mulliri është që njerëzit e tij luftojnë me mullinj të erës së pushtetit dhe të qeverisë për të gjetur ujë për mullirin e tyre, pra këtu është edhe ana e cinizmit. Ajo shprehja cinike: “Është mulli me erë, por nuk po e kuptoj se nga vjen uji” për këtë mulli është. Është mulli me ujë, por nuk po shikoj se nga i vjen uji. Nuk i vjen uji, sepse e ka bllokuar HEC-i i ndërtuar atje, “Erdu Energy”, i cili nuk zbaton kontratën koncesionare, që e detyron të lërë kanalin e ndërtuar për furnizimin e tij, me qëllim që 10 fshatra të mbajnë shpirtin gjallë me bukë. A e kuptoni se çfarë luksi kemi ne, flasim për trashëgimi kulturore, ndërkohë që pjesa më madhe e këtij vendi lufton çdo ditë për ekzistencë, për bukën e gojës dhe bllokohet me veprime të tilla, sepse dikush do të nxjerrë para më shumë. Po çfarë bën qeveria? Qeveria për inat të mullixhiut (është ajo shprehja, mullixhiu është i PD-së, është cilësuar si armik klase) fle me pronarët e HEC-it dhe bën sikur e kontrollon dhe vazhdimisht e bllokon. Ata njerëz bëjnë kilometra të tërë me thasët në kurriz ose me kafshët e punës për të bluar grurin për bukën e fëmijëve të tyre.

Kjo është tragjedia dhe ky është realiteti. Sot duhet të reagojmë patjetër ndaj kësaj tragjedie; ndaj kësaj trashëgimie të shpifur të përcimit të njerëzve të thjeshtë, që jetojnë jashtë qendrave urbane. Kjo lloj sjelljeje ndaj trashëgimisë në mënyrë armiqësore e politike, por edhe çnjerëzore duhet të marrë fund, pastaj të flasim edhe për trashëgimitë e tjera. Kjo çështje duhet të nisë e të marrë zgjidhje, sepse askush nuk ua vë veshin atyre banorëve që kanë shëtitur në të gjitha institucionet, kanë marrë përgjigje nga infrastruktura. Është e vërtetë, sepse ajo që duhet përmendur, duhet përmendur, aty përcaktohet qartazi që HEC-i duhet të zbatojë kontratën, madje në verë nuk duhet të punojë fare për 3 muaj. Por, nuk pyet njeri, lumi i “Gurakuqit” është tharë komplet, sepse HEC-i bllokoi të gjithë ujërat që vijnë nga lumi kryesor për ta shfrytëzuar për prodhimin e energjisë. E futa këtë çështje në mes, sepse nuk dua t’u të marr kohë kolegëve të mi për çështjet e publikut në fund të seancës. Për ta mbyllur dua të them që lufta jonë për trashëgiminë jetësore, për trashëgiminë kulturore sot i ngjan dhe është një luftë mes betonit, mes kullave, miliona të eurove dhe historisë sonë të brishtë, objekteve kulturore që nuk kanë mbi asnjë fuqi tjetër, përveç identitetin tonë për mijëra vjet. Deri tani kanë fituar betoni kulla dhe paraja.

Thirrja ime bashkë me qytetarët është: duhet t’i ndryshojmë të dyja sjelljet ndaj trashëgimisë kulturore, që të fitojë identiteti i mijëra viteve të historisë dhe krenarisë sonë dhe t’i japim fund trashëgimisë së sjelljes çnjerëzore ndaj njerëzve të thjeshtë. Por këtë duhet ta bëjmë bashkë me qytetarët. Faleminderit!